



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:051220

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06189268

P.nr.70/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Dega Podujevë/Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri me procesmbajtës-bashkëpunëtor profesional Izet Hyseni, në çështjen penale kundër të pandehurit M. H., për shkak të veprës penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse” nga neni 364 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.7348/2023, të datës 26.02.2024, pas përfundimit të seancës publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 17.09.2024, në praninë e të prokurorit të shtetit Besart Mustafa, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. A. S., me datë 18.09.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M. H., nga i ati A. dhe nëna F., mbiemri i vajzërisë M., i lindur më ... në fshatin R. i v., Komuna e L., ku edhe jeton, me numër personal të identifikimit ... , ka të kryer shkollën fillore, me profesion shofer autobusi në agjencionin “B. T.”, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 03.12.2023, rreth orës 09:30, në kalimin kufitar K.-S. saktësisht në pikën kufitare M., i pandehuri në kundërshtim të ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, ka importuar armë përkatësisht ... e, në atë mënyrë që i njëjti duke përdorur autobusin e agjencionit “B. T.” i cili ka qarkulluar në relacionin S.- K., në cilësinë e shoferit, me dashje dhe vetëdije e ne kundërshtim me nenin 3 pika 1.7 lidhur me nenin 4 par 1 pika 1.4.4 te ligjit dhe nenit 2 par 1 pika 1.2.1 e Udhëzimit Administrativ, pa autorizim në vende publike ka poseduar armë te ftohta – ... , pa leje përkatëse për transportimin e armëve, ashtu që ditën kritike gjatë kontrollimit të vijës së dytë të bërë nga policia kufitare dhe dogana e Kosovës në bagazhin e autobusit janë gjetur ... e ... (...) ... me k..., modeli ... , të cilat po i transportonte për në K. e të cilat më pas konfiskohen nga policia e Kosovës.

- me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse” nga neni 364 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitave ligjore të nenit si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe të neneve 276, 364, 365, 367, dhe 449 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me Dënim me Gjobë dhe Dënim me Kusht

I. Ashtu që i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumë prej pesëqind (500) Euro, të cilën i pandehuri detyrohet ta paguaj në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

II. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

III. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në afatin e përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

IV. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale/për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. KONFISKOHEN ... e ... (...) ... “G. M. S.” model ... , si mjet i kryerjes se veprës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr.7348/2023, të datës 26.02.2024, kundër të pandehurit M. S., për shkak të veprës penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse” nga neni 364 par. 1 të KPRK-së.

Pas hapjes së seancës së shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 17.09.2024, konstatimit të prezencës së palëve, udhëzimit për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të pandehurit i ofroi mundësinë e deklaramit rreth fajësisë – të pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: E pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke i pohuar në tërësi faktet e përshkruara si në aktakuzë, nga gjykata kërkoi një dënim sa më të butë, duke premtuar se nuk do te bie më në ndesh me ligjin.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar se: Pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që i njëjti është bërë në konsultim te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe konform dispozitave ligjore të KPPRK-së, ashtu që gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës. Gjykatës i propozoi që të aprovojë pranimin e fajësisë dhe të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit por që me rastin e marrjes së vendimit mbi shqiptimin e dënimit të merr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

Mbrojtësi i të pandehurit M. H., av. A. S., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se: Pranimi i fajësisë nga i pandehuri bë në konsultim te mjaftueshëm me te si avokat mbrojtës, gjykatës i propozoi që ta aprovoje te njëjtin dhe te ketë parasysh rrethanat deri te kryerja e veprës penale, deklarimin e te mbrojturit te tij, me që sipas tij i mbrojturi i tij nuk ka qene në dijeni lidhur me procedurat dhe transportin e këtyre mjeteve te cilat prokuroria i klasifikon si arme apo materiale plasëse, duke shtuar se i njëjti është shofer agjencioni autobusësh, i cili këto mjete i ka marrë si donacion për “Sh. e Gj. ne L.” dhe nuk ka pasur qellim tregtie me to. Nga gjykata kërkoi që të gjitha të lartcekurat ti merr si rrethana lehtësuese si dhe faktin se i mbrojturi i tij është mbajtës i vetëm i familjes, prind i katër fëmijëve dhe premtimin e tij se nuk do te bie me ndesh me ligjin.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse” nga neni 364 par. 1 të KPRK-së dhe me aplikimin e dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës që përcaktojnë mundësinë e të konsideruarit si rrethanë lehtësuese pranimin e fajit për të pandehurin (neni 70 par. 3 nën par. 3.10 i KPRK-së), si dhe dispozitave ligjore për zbutjen e dënimit nën kufirin e paraparë andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi që është vërtetuar plotësisht dhe jashtë çdo dyshimi se tani i pandehuri M. H. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se i njëjti është penalisht i përgjegjshëm, kjo gjykatë të njëjtin e shpalli fajtor dhe me aplikimin e dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës që përcaktojnë mundësinë e të konsideruarit si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë për të pandehurin. (neni 70 par. 3 nën par. 3.10 i KPRK-së) dhe dispozitës ligjore të nenit 71 par. 1 nën-par 1.3 të KPRK-së për zbutjen e dënimit nën kufirin e paraparë me ligj, gjykata i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimet e tij, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, faktin se i pandehuri është prind i katër (4) fëmijëve dhe mbajtës i vetëm i familjes dhe premtimin e tij se më nuk do të bie ndesh me ligjin, andaj erdhi në përfundim se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv te këtij aktgjykimi është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse

i njëjti kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në bazë të nenit 276 par. 1 dhe par.2 nën-par. 2.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të neneve 230 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr. 70/24, datë 20.09.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.